



Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
Nr.07/353-45362
Dt.13.01.2017

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit duke vendosur sipas kërkesës së parashtruar nga: **“Karakushi” SH.P.K, e regjistruar me numër të biznesit 70498324, dhe me pronar Mehmet Karakushi** nga fshati Raqë komuna e Gjakovës, për dhënjën e Lejes së Ndërtimit për Realizimin e Fazës së Parë, së Tregut me shumicë, në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21, si dhe Ligjit për Procedurën Administrative Nr 02/L-28 nenit 11, bien këtë:

A K T V E N D I M

I. I LEJOHET: aplikuesit: **“Karakushi” SH.P.K, e regjistruar me numër të biznesit 70498324, dhe me pronar Mehmet Karakushi** nga fshati Raqë komuna e Gjakovës, Realizimi i Fazës së Parë, të Tregut me shumicë, konform Planimetrisë së Organizimit Hapësinor të Tregut me Shumicë, të punuar në përputhshmëri me Kriteret për shpalljen publike për tregun me shumicë, me 12.08.2016, zyrt., nga Komisioni për kriteret e tregut me shumicë, dhe të aprovuar nga Komisioni Mbikqyrës për vlerësimin e tregut me shumicë, sipas Procesverbalit me nr.09/zyrtarisht/2016, dt.12.09.2016, me vërejtjet e poshtëshënuara, në ngastrat kadastrale me nr. 5041/3 dhe 5043/1, ZK: Gjakovë -J- Qytet, në rrugën “Gaspër Karaqi”, në pronësi të të lartëpërmendurit.

FAZA E PARË, e ndërtimit – realizimit të Tregut me shumicë përfshin:

- Rrethimin e lokacionit i cili duhet të jetë transparent (me tela apo rrjetë metalike).
- Rregullimi i jashtëm, rrespektivisht rrugët komunikuese, stazat, parkingjet dhe pllato të.
- Vendosjen e nyjeve sanitare (WC-të), përmes kalimeve portable dhe pikave të pastrimit.
- Vendosjen e katër kontejnerve të mbeturinave.

VËREJTJE: Vendosja e objektit montues – demontues i cili është i paraparë me destinim “Hotelier – Kantinë”, si dhe vendosja e kontejnerëve të punëtorëve të realizohet në fazën tjetër.

II. Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është Planimetria e Organizimit të hapësirës së Tregut me shumicë për të cilin është dhënë pëlqimi përkatës Komisioni Mbikqyrës për vlerësimin e tregut me shumicë dhe nga organi kompetent i cili është bazë për rilevimin gjeodezik të organizimit të tregut nga pika 1 e këtij aktvendimi.

III. Investitori është i obliguar:

- Që të ruaj një ekzemplar origjinal të dokumentacionit teknik në bazë të të cilit i është dhënë kjo Leje Ndërtimi;
- Që pa pëlqimin e hartuesit të projektit kryesor dhe pëlqimin e kësaj Drejtorie, të mos bëjë asnjë ndryshim në projekt;
- Ekzekutimi i punimeve nga pika 1 e këtij Aktvendimi, të realizohet nën mbikëqyrjen e organit mbikqyrës për realizimin e ndërtimit të objektit.
- Të lajmëroj Drejtorinë për Punë Inspektuese, për ditën e fillimit të punës së paku 8(tetë) ditë para fillimit të ndërtimit, me qëllim të verifikimit të lokacionit të piketuar.
- Për Objektet e kategorisë së dytë, Investitori duhet që për secilën fazë të ndërtimit, të parashtrorë kërkesë, pranë Drejtorisë për Punë Inspektuese, me qëllim të Inspektimit dhe përcjelljes së realizimit të punimeve nga secila fazë, si dhe kompletimin e dokumentacionit të nevojshëm për lëshimin e Certifikatës - Lejes së Përdorimit të objektit.

IV. Kjo Leje Ndërtimi vlen 1(një) vit nga dita e lëshimit të këtij aktvendimi.

Arsyetim

“Karakushi” SH.P.K, e regjistruar me numër të biznesit 70498324, dhe me pronar Mehmet Karakushi nga fshati Raqë komuna e Gjakovës, me seli po ashtu në fshatin Raqë, ka parashtruar kërkesën pranë DUMM me nr. 07/351-45362, të datës 17.10.2016 për dhënjen e Lejes së Ndërtimit për Realizimin e Fazës së Parë, së Tregut me shumicë, në ngastrat kadastrale me nr. 5041/3 dhe 5043/1, ZK: Gjakovë -J-Qytet, në rrugën “Gaspër Karaqi”, në pronësi të të lartëpërmendurit, siq është përshkruar në pikën 1 të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Së bashku me kërkesën investitori e ka prezantuar edhe këtë dokumentacion:

1. Planin e Situacionit në përpjesë 1:500 , të datës 21.03.2016, i vërtetuar nga N.P.SH.”GELI”-Gjakovë.
2. Kopjen e planit të datës 03.10.2016, në pronësi të Mehmet (Rexhë) Karakushi nga fsh,Raq komuna e Gjakovës, lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
3. Çertifikatën mbi të drejtën në pronën e paluajtshme(fotokopje) me nr.të lëndëve 6018-16, dt.04.11.2016,dhe nr.5444-16, dt.03.10.2016, të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
4. Procesverbalin me nr.09/zyrtarisht/2016, dt.12.09.2016, nga Komisioni Mbikqyrës për vlerësimin e tregut me shumicë.
5. Kriteret për shpalljen publike për tregun me shumicë, me 12.08.2016, zyrt., nga Komisioni për kriteret e tregut me shumicë.
6. Certifikata për Regjistrimin e Biznesit në emër të kompanisë “Karakushi”SHPK, me nr. të biznesit 70498324, nga Minsitria e Tregëtisë dhe Industrisë, e Republikës së Kosovës.
7. Ftesa për aplikim – ofrimin e pronës private me qëllim të shfrytëzimit të saj për tregun me shumicë, nga Komuna e Gjakovës, sipas kriterëve për shpalljen publike për tregun me shumicë, nr. zyrt, dt.12.08.2016, nga Komisioni për Kriteret e tregut me shumicë.
8. Përfundimin i Bordit të Drejtorëve, me nr. 01 Nr.06-35789-10/2, dt.14.07.2016, mbi aprovimin e kërkesës së Drejtorisë për Shërbime Publike për formimin e Komisionit për përgatitjen e kriterëve për shpalljen publike për marrjes e hapësirës private për shfrytëzimin e tregut me shumicë.
9. Planimetria e organizmit hapësinor të tregut, e aprovuar nga Komisioni Mbikqyrës për vlerësimin e tregut me shumicë dhe nga organi kompetent.

Sipas Rregullores për Taksa, Tarifa dhe Ngarkesa nga Shërbimet Komunale, me nr. 01 Nr.011-43964/2015, dt.30.-6.2015, për Realizimin e Tregut me shumicë, nuk parashifet ngarkesë administrative.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij Aktvendimi,pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorzim. Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor në Prishtinë, dhe e njejta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.

Aktvendimi i dorëzohet:

- Investitorit,
- Drejtorisë së Inspektionit ,
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Arhivës.

Zyrtar i lartë për çëshjte juridike

Zenel Shabani.jur.dipl.

U.D. Drejtori

Elida Bejtullahu, inxh.e dipl.e ark.

KOPJE PLANI

Zona kad. Gjakovë-Jasht-Qytet

Shk. zvog. 1: 2500

Poseduesi: Karakushi Mehmet (Rexh)
nga Raqa.




HIPOTEK:
Banka për Biznes
BpB-SHA

Numri rendor i regjistrimit të taksave kadastrale:

Nr. Parcelës	Plani	Vendi i quajtur	Kultura	Klasa	Sipërfaqja			Vërejtjet
					Ha	a	m	
5041/3		Nakarade	livadhë	3	0	19	46	
5043/1		Nakarade	arë	4	0	40	21	
5044		Nakarade	arë	4	0	59	90	
Gjithësejtë						19	57	

Që kjo kopje e planit është besnike e origjinalit të vet sipas gjendjes në kadastër duke paguar taksën sipas vendimit të KK GJAKOVË.

Gjakovë 03.10. të vitit 2016



VËRTETON: